

**URDHËR**  
**Nr. 296, datë 18.4.2024**

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E OHRIT DHE GRUMBULLIMIN  
E RIPRODHUESVE TË KRAPIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin të të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Ohrit (me përjashtim të koranit), konkretisht:

- a) për gjuhçën (cironka) – *Alburnus Albidus Alborella*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2024;
- b) për krapin – *Cyprinus Carpio*, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2024.

2. Për periudhën 20.7.2024 deri më 20.8.2024, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP Pogradec.

4. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), të koordinojë veprimtarinë organizative, teknike dhe financiare me Qendrën e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, për gatishmërinë e marrjes së riprodhuesve të krapit (*Cyprinus Carpio*).

5. Për periudhën prej 20.4.2024 deri më 31.5.2024 të lejohet peshkimi i riprodhuesve të krapit në përputhje me kapacitetet mbajtëse të Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit, në fshatin Lin të Pogradecit.

6. Veprimtaria e grumbullimit të riprodhuesve, të organizohet dhe kryhet nën drejtimin e DSHPA-së në bashkëpunim me OMP Pogradec, duke përcaktuar dhe aktivizuar për këtë qëllim jo më shumë se 20 peshkatarë me përvojë, anëtarë të kësaj OMP-je.

7. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në koordinim me OMP Pogradec.

8. OMP Pogradec të marrë të gjitha masat për zhvendosjen e objekteve, ku peshqit kanë lëshuar vezët në mënyrë natyrale, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqen.

9. Ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Qendra e Prodhimit të Rasateve në fshatin Lin të Pogradecit, si dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Pogradec, të bashkëpunojë me strukturat vendore Pogradec, Komisariatit e Policisë, Policinë Tatimore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Korçë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**Anila Denaj**